



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.02.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 117/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për ri-shqyrtim të datës 09.02.2021, të parashtruar nga OE BLENDI dhe OE AGIMI-DE, HAJRIJE SELMANAJ B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material te shtypur”, me Nr. të Prok: 632-20-5688-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohen si te pabazuara Kërkesat për ri-shqyrtim e OE BLENDI dhe OE AGIMI-DE, HAJRIJE SELMANAJ B.I. te dates 09.02.2021, lidhur me aktivitetin e “Furnizim me material te shtypur”, me Nr. të Prok: 632-20-5688-5-1-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 05.02.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 05.02.2021;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

OE BLENDI dhe OE AGIMI-DE, HAJRIJE SELMANAJ B.I. me datë 09.02.2021, kane parashtruar Kërkesat për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material te shtypur”, me Nr. të Prok: 632-20-5688-5-1-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.02.2021, ka shqyrtuar Kërkesën në fjalë si më poshtë:

OE ankues nr. 1 BLENDI:

Në lidhje me pretendimin ankimor se është bërë shkelje e nenit 7, AK sqaron se nuk ka bërë shkelje pasi që është shpallur fitues OE me cmimin më të ulët dhe për cmimet është kërkuar sqarim tek OE edhe konform Vendimit të OSHP.

Në lidhje me pretendimin ankimor se OE ankues është eliminuar është eliminuar se nuk është dorëzuar sigurimi i tenderit, AK sqaron se fare nuk ka qenë pikë ankimore pasi që OE ankues është shpallur OE i pasuksesshëm dhe jo i eliminuar.

Në lidhje me pretendimin ankimor se OE ankues se OE fitues nuk ka dorëzuar Deklaratën e specifikacionit Teknik, AK sqaron se ajo është pjesë e shabllonit të dosjes së tenderit dhe se nuk ka qenë kërkesë e kërkesave të kapacitetit teknik e profesional e as kërkesave tjera konform neneve 66, 68 dhe 69 të LPP si dhe sipas RRUOPP Deklarata për specifika teknike kërkohej kur (shih tekstin që thote udhezuesi) “Përveç në raste kur OE nuk mund të dorëzojë specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/perime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklarohet se mallrat do të jenë në përputhje me specifikimin e kërkuar” dhe OE i rekomanduar për dhënie ka plotësuar listën e cmimeve konform asaj që është kërkuar ku mund të shihet i gjithë përshkrimi i specifikave teknike të dosjes së tenderit.

Në lidhje me pretendimin ankimor se OE ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 61, AK sqaron se pas kalkulimit del që OE i rekomandues për dhënie ka cmime abnormalisht të ulëta mirëpo për to janë kërkuar sqarime shtesë tek OE dhe konform Rregullat për Tenderet Jo-Normalisht të Ulet dhe ka konsideruar se dëshmitë e ofruara janë janë të mjaftueshme konform nenit 4.6.1. të kësaj rregulloreje.

OE ankues nr. 1 AGIMI-DE, , HAJRIJE SELMANAJ B.I.:

Në lidhje me pretendimin ankimor se OE ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 7, 59 dhe 61 të LPP dhe nenit 3 , AK sqaron se pas kalkulimit del që OE i rekomandues për dhënie ka cmime abnormalisht të ulëta mirëpo për to janë kërkuar sqarime shtesë tek OE dhe konform Rregullat për Tenderet Jo-Normalisht të Ulet dhe ka konsideruar se dëshmitë e ofruara janë janë të mjaftueshme konform nenit 4.6.1. të kësaj rregulloreje.

Në lidhje me pretendimin ankimor se OE ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 60 se ka shpallur fitues OE të papergjegjshëm, AK sqaron se ka shpallur OE të pergjegjshëm me cmimin më të lirë.

Tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se cmimi juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve nga publikimi i Vendimit në platformën elektronike <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>


Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Grupi i OE Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës